

V E N D I M
Nr.42 datë 29.1.1993

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.445, DATË 13.12.1991 "PËR VËRTETIMIN E KOHËS SË VUAJTJES SË
DËNIMIT ADMINISTRATIV NGA ISH-TË INTERNUARIT E TË DËBUARIT PËR
ÇËSHTJE POLITIKE KUR MUNGOJNË DOKUMENTET ZYRTARE"

Me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.445 datë 13.12.1991, pika 3 ndryshohet si vijon:
"Qenia i internuar ose i dëbuar mund të vërtetohet në rrugë administrative gjer në datën 30.6.1993".
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.436, datë 10.10.1992, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi